

# AKT THEMELUES

## I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

### “AUTO VOLS” SH.P.K.

Unë Erelis Bako, i biri i Qemalit, dtl 25.06.1983, banues ne Rr Xhanfize Keko ,pll Invest ap 18 ,Tirane  
Dhe

Unë Luan Mlika, i biri i Bajramit, dtl 02.04.1976, banues ne Rr. Zihni Sako Komleksi Kolombo 2 G/2 K4 Ap 25 Tirane

Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ” dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”, sot më datë 14.07.2021, krijojme shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “AUTO VOLS ” , me aktin themelues të saj si vijon :

### FORMIMI

#### NENI 1

Formohet shoqëria private e quajtur “AUTO VOLS ” sh.p.k. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

### SELIA E SHOQERISE

#### NENI 2

Selia e shoqërisë tregtare private “AUTO VOLS\_” sh.p.k. do të jetë :  
Njesia bashkiake Nr 7, Bulevardi Gjergj Fishta, Pallati nr 22, Njesia nr 8, Tirane



Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

#### NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:

1. Autoshkolle duke përfshirë të gjitha llojet e shërbimit të kësaj fushe.
2. Dhenie me qera të atoveturave, motorrave dhe mjeteve të tjera.
3. Tregtimit me shumicë e pakicë dhe import-eksport të atoveturave

Mallra industriale, lëndë të para, pjesë këmbimi për makina, hidro – sanitare, hidraulike, kanceleri për zyra e shkolla, orendi shtëpiake, mobilje të ndryshme, pajisje elektrike e elektronike, kinkaleri, elektro – shtëpiake, kompiuterike, pjesë këmbimi për automjete.

#### NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

#### NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

### KAPITALI I SHOQERISE

#### NENI 6



Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private "AUTO VOLS" sh.p.k. do të jetë **2.000.000** (nje milion) lekë dhe do të përbëhet nga kuotat e ortakeve themelues të shoqërisë. Kapitali përbëhet nga **2** kuota dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **1.000 000** lekë.

Z. Erlis Bako zotron 1 kuote me vlere 1.000 000 leke qe perbene 50% te kapitalit themeltar

Z. Luan Mlika zotron 1 kuote me vlere 1.000 000 leke qe perbene 50% te kapitalit themeltar

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakeve themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

#### NENI 7

Ortaku i vetëm duhet të bëjë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjerë dhe të shoqërisë.

### DREJTIMI I SHOQERISE

#### NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Z. Erlis Bako, i cili është përfaqësues ligjore i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej **5** vjet me të drejtë ripërtëritje.

#### NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut themelues të shoqërisë.

#### NENI 10

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktojë financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

#### NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### NENI 12



Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”.

NENI 14

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare “AUTO VOLLS\_” sh.p.k.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

“AUTO VOLLS” sh.p.k

ERLIS BAKO

*Erlis Bako*



*Tiranë 14.07.2021*

LUAN MLIKA

*Luan Mlika*

